



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1016/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “B...” ShPK me seli në Deçan, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2184/17, të datës 28.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.02.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa, e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.2184/17 i datës 28.01.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.2184/17 të datës 28.01.2021, është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditësit “B...” me seli në Deçan, është anuluar aktvendimi nr.07.3/996/2014 i datës 09.11.2017 i Doganës së Kosovës në Prishtinë me të cilin është refuzuar kërkesa e këtu paditësit për rishqyrtimin e deklaratave unike doganore R-7147/16.06.2014, R-7149/16.06.2014, R-7529/21.06.2014 dhe R-7607/21.06.2014 të Zyrës Doganore Pejë dhe është obliguar e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë që paditësit “B...” me seli në Deçan, t’ia kthej mjetet e paguara më tepër si rezultat i rivlerësimeve për deklaratat unike doganore R-7147/16.06.2014, R-7149/16.09.2014, R-7529/21.06.2014 dhe R-7607/21.06.2017, të zyrës Doganore Pejë, në emër të taksës doganore 10% dhe TVSH 16% në shumë prej 23,923.13€ me kamatë ligjore 8% nga nxjerrja e aktgjykimit e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore procedurale, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa në tërësi si e bazuar ligj, Prishet aktgjykimi A.nr.2184/17 i datës 28.01.2021 si i pa bazuar në ligj dhe ta le në fuqi vendimin e kontestuar ose t’ia kthej lëndën Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Aktvendimin e kundërshtuar nr.07.3/996/2014 të datës 09.11.2017, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë “B...” me seli në Deçan, për rishqyrtimin e vendimeve R-7147/16.06.2014, R-7149/16.06.2014, R-7529/21.06.2014 dhe R-7607/21.06.2014 të ZD Pejë.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e të paditurës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, duke anuluar vendimin lartcekur të paditurës, si dhe duke obliguar të paditurën Dogana e Kosovës, në Prishtinë, që paditësit “B...” me seli në Deçan, t’ia kthej mjetet e paguara më tepër si rezultat i rivlerësimeve për deklaratat unike doganore R-7147/16.06.2014, R-7149/16.09.2014, R-7529/21.06.2014 dhe R-7607/21.06.2017, të zyrës Doganore Pejë, në emër të taksës doganore 10% dhe TVSH 16% në shumë prej 23,923.13€ me kamatë ligjore 8% nga nxjerrja e aktgjykimit e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përbarimit ligjor. Në arsyetimin e aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se Gjykata konstaton se paditësi në procedurë administrative tek e paditura, por edhe në këtë konflikt administrativ ka paraqitur dokumentacionin valid si provë për DUD-at me nr.R-7147/16.06.2014, R-7149/16.06.2014, R-7529/21.06.2014 dhe R-7607/21.06.2014 të Zyrës Doganore Pejë dhe atë faturën me nr.41/10.06.2014, 42/10.06.2014, 43/16.06.2014, 44/16.06.2014, deklaratat eksportuese të datës 13.06.2014, 17.06.2014, dokumentin e transportit të mallit ‘CMR’ 0032336, 1245681, 0050973 dhe 0080720, listë ngarkesa e mallit e datës 11.06.2014 dhe 16.06.2014 si dhe transaksionin bankar të datës 24.03.2014, me përshkrimin referencë faturat kontestuese, në vlerë prej 19,958.40€, vlerë kjo e cila përputhet saktësisht me vlerën e faturave 41, 42, 43 dhe 44, të DUD-ave kontestues. në këto rrethana gjykata bazuar edhe në konstatimet e ekspertës, në ekspertizën financiare vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara sa i përket vlerë së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore,

të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore, si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, ngase aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës administrative, e as me shkelje të tjera të cilat do të ndikonin në drejtëshmërinë dhe ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së, dhe LPA-së. Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës, për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, këtë pretendim e Kolegji i kësaj gjykate e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kjo gjykatë, as në ankesë, e as në shkresat e lëndës, nuk ka gjetur asnjë provë bindëse që dëshmon konstatimin se paditësi ka deklaruar vlerë më të vogël se sa vlera reale e paguar për eksport në vendin tonë, ashtu siç e përcakton neni 33 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të Kosovës. Në këtë rast e paditura para gjykatës është dashur që me prova bindëse të dëshmojë se ia ka paguar paditësit – eksportuesit të mallit vlerën më të vogël se sa vlera e deklaruar me DUD-at kontestues, si dhe faturat përcjellëse të mallit lëndor, gjë që nuk e ka bërë një gjë të tillë. Të paditurës i është dhënë mundësia që t'i paraqes të gjitha provat dhe faktet bindëse që dëshmojnë se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por një gjë të tillë nuk e ka bërë, por e njëjta vetëm se ka pretenduar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, por pa e mbështetur pretendimin e saj në dispozitat ligjore konkrete. Dhoma e Shkallës së Dytë, e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë me të cilën ka vlerësuar se paditësi ka dëshmuar para të paditurës dhe gjykatës paditësi ka paraqitur dokumentacionin valid si provë për DUD-at me nr.R-7147/16.06.2014, R-7149/16.06.2014, R-7529/21.06.2014 dhe R-7607/21.06.2014 të Zyrës Doganore Pejë dhe atë faturën me nr.41/10.06.2014, 42/10.06.2014, 43/16.06.2014, 44/16.06.2014, deklaratat eksportuese të datës 13.06.2014, 17.06.2014, dokumentin e transportit të mallit 'CMR' 0032336, 1245681, 0050973 dhe 0080720, listë ngarkesa e mallit e datës 11.06.2014 dhe 16.06.2014 si dhe transaksionin bankar të datës 24.03.2014, me përshkrimin referencë faturat kontestuese, në vlerë prej 19,958.40€, vlerë kjo e cila përputhet saktësisht me vlerën e faturave 41, 42, 43 dhe 44, të DUD-ave kontestues. Në këto rrethana gjykata bazuar edhe në konstatimet e ekspertes, në ekspertizën financiare vlerëson se të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara sa i përket vlerë së mallit të importuar në kuptim të nenit 33 par.1 të KDAK-së.

Gjendja faktike në këtë konflikt administrativ është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditës, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në

mënyrë të drejtë dhe të plotë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për vlerën provuese dhe besueshmërinë e ekspertizës financiare, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe Kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadsisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1016/22, me datë 20.02.2023

Kryetar i kolegjit,
Ramush Bardiqi